

## PROÇEDURAT ADMINISTRATIVE PËR FREKUENTIMIN & MUNGESAT PA ARSYE

### I. QËLLIMI:

Të ofrojë procedurat dhe udhëzimet e përgjithëshme për frekuentimin dhe mungesat e pajustificuara, të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias

### II. PERGJEGJËSIA:

Frekuentimi & mungesat e pajustificuara; Zyra për Të Drejtat & Përgjegjësitë e Nxënësve, është përgjegjëse për rishikimin dhe paraqitjen e referencave për nxënësit me 10, ose më shumë mungesa të pajustificuara në Gjykatën e Familjes, ose në Departamentin e Shërbimeve Njerëzore (DHS) për veprime dhe shërbime të mëtejshme ndërhyrëse. Ndërhyrjet dhe shërbimet janë konceptuar si ndihmë për frekuentimin e rregullt të shkollës.

### III. KRITERET:

Ligji i Shkollave të Pensilvanisë, kërkon që shkolla të ndiqet rregullisht çdo ditë, nga nxënësit e moshës 8-17 vjeç. Meqë Filadelfia është Drejtori e klasit të parë, kërkesat për vazhdimin e shkollës nga nxënësit shtrihen në moshat 6-17 vjeç. Një nxënës i regjistruar në shkollë, mund të çregjistrohet vetëm në rast se ai/ajo transferohet jashtë Drejtorisë Arsimore. Nxënësi do të mbetet i regjistruar në amzën e Drejtorisë Arsimore dhe fëmija/familja do të jenë subjekt i Gjykatës së Mungesave pa arsye, nëse ata nuk vazhdojnë shkollën.

### IV. PROÇESI PËR FREKUENTIMIN:

#### A. Proçesi Shkollor

1. Prindërit **duhet të paraqesin** një shënim për mungesën në shkollën përkatëse **brenda tre ditëve** që fëmija ka bërë mungesë të pajustificuar. Pas tre ditëve, Drejtori/ I Ngarkuari për mungesat, do të bëjë vlerësimin nëse justifikimi është i pranueshëm. Në rast se justifikimi është i pranueshëm, mësuesi do të bëjë korigjimet në regjistër dhe t'i kalojë ato në sekretari, në mënyrë që të bëhen korigjimet në kompjuterin e shkollës (SCN) ose në shënimet e shkollës.
2. Në mungesën e 3<sup>të</sup> të pajustificuar do të dërgohet njoftim te Prindi/Kujdestari C-31 (Njoftim Zyrtar për Tre Ditë), që tërheq vëmendjen se fëmija ka munguar 3 ditë (rrjesht/në total) në shkollë.
3. Në mungesën e 6<sup>të</sup> të pajustificuar, shkolla mund të përdorë Modulin e Ndërhyrjes Online (MTSS/RtII) dhe të krijojë një plan frekuentimi për nxënësin. Shkolla do të organizojë një takim me prindin/kujdestarin e fëmijës, duke kërkuar shpjegime për mungesat dhe hartimin e një plani për heqjen e pengesave për mungesat e pajustificuara.
4. Në mungesën e 10<sup>të</sup> të pajustificuar, do të bëhet Referimi për këto mungesa në Zyrën e Frekuentimit & Mungesave të Pajustificuara.
5. Me dërgesën e referimit në Zyrën e Frekuentimit & Mungesave të Pajustificuara, mund të duhen deri 6 javë që nxënësi/familja të marrin një ftesë për në Gjykatën e

Mungesave të Pajustificuara. Shkollat mund të shikojnë S73 (Pasqyra e Aktivitetit të Gjykatës) në Networkun e Shkollës (SCN), në rastet e nxënësve që janë dërguar në gjykatë.

6. Klasat K-3 duhet të paraqiten në Faqen Referuese DHS, e cila mundësohet nga uebsajti i zyrës.
7. Klasat 4-11<sup>të</sup> duhet të paraqiten në Faqen Referuese të Gjykatës së Familjes, e cila mundësohet nga uebsajti i zyrës.
8. Vëllezërit dhe motrat nga e njëjta shkollë, duhen paraqitur bashkërisht në faqet e referimit.

**B. Si paraqitet një Referim për Mungesat e Pajustificuara:**

Shkollat kanë detyrim të paraqesin çdo datë 25 të muajit Referencat për Mungesat pa Arsye në Zyrën e Frekuentimit dhe Mungesave të Pajustificuara, me adresë 440 North Broad Street. Referencat mund të dërgohen me email në [attendanceandtruancy@philasd.org](mailto:attendanceandtruancy@philasd.org), fax në 215-400-4223, ose dorazi në Zyrën e Frekuentimit & Mungesave të Pajustificuara, në numrin 440 (Qendra Mësimore).

**C. Si procedohet pasi referenca është dërguar?:**

Familja do të marrë njoftim nga Gjykata e Familjes e Filadelfias, që të paraqitet në Gjykatën e Mungesave Të Pajustificuara. Thirrja do të ketë datën, orën dhe vendin ku duhet të paraqitet familja. Në vazhdim, një kontraktor i DHS për mungesat pa arsye do të kontaktojë familjen për takim. Ky takim është për shtrirjen e shërbimeve për heqjen e pengesave të mungesave pa arsye. Kontraktori do të punojë me familjen deri sa çështja të ketë përfunduar nga gjykata e mungesave. Proçesi në Gjykatë mund të vazhdojë deri në 120 ditë, vartësisht nga problematika e çështjes. Çdo çështje do të procedohet individualisht, duke marrë në konsideratë faktorët e ndryshëm.

**D. Si bëhen korigjimet në rekordet e frekuentimit të nxënësve?:**

Në rastet kur një prind mendon se ka gabime në rekordet e frekuentimit të fëmijës së tij, ai ka të drejtën t'a trajtojë këtë shqetësim me shkollën. Ata duhet të paraqesin dokumentacionin e duhur, në mënyrë që të mund të bëhen ndryshimet. Ky dokumentacion duhet të konsistojë në njoftimin me shkrim dore të prindit, në rast se kjo është dërguar më përpara 3 ditëve të munguara. Kërkohej raporti i mjekut në rast të mungesave në vazhdim në total prej 3 ditësh, ose më tepër. Menjëherë që informacioni të paraqitet në shkollë, drejtori, ose i ngarkuari prej tij, do të miratojnë ndryshimet. Ndryshimet e miratuara do të reflektohen gjithashtu edhe në regjistër.

**E. Ndryshimet në Politikën e Frekuentimit**

**A. Politika e Mungesave të Justifikuara:**

- i. Në përputhje me politikën e Drejtorisë Arsimore për frekuentimin, të gjitha sëmundjet që rezultojnë në një total prej 3 ose më shumë ditëve në vazhdim, kërkojnë raport justifikimi nga mjeku
  - ii. Për mungesat për arsye shëndetësore, të cilat nuk e kalojnë totalin e 3 ditëve në vazhdim, prindërit mund të japin një justifikim që thekson arsyen shëndetësore. Kur nxënësi që mungon për arsye shëndetësore dhe justifikohet nga prindërit më shumë se 8 herë (të mledhura në total), do të kërkohet një raport nga mjeku për shkollën, i cili të justifikojë mungesën e 9<sup>të</sup> ose të tjerat, për arsye shëndetësore.
- B. Rregulli për ardhjen me Vonesë:
- i. Nxënësi që vjen në shkollë pas orës 10:00 am dhe/ose largohet nga shkolla përpara orës 1:00 pm, pa një justifikim, do të trajtohet në përputhje me rregullin e SDP për frekuentimin, si një gjysëm dite mungesë e pajustificuar. Dy gjysma ditësh të pajustificuara do të llogariten si një ditë e plotë mungese e pajustificuar.

F. Pyetje ose Shqetësime:

Ju lutemi mësoni për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Nxënësit (Frekuentimi & Mungesat e Pajustificuara) me telefon në 215-400-4220 ose email në [attendanceandtruancy@philasd.org](mailto:attendanceandtruancy@philasd.org)

## V. POLITIKA QË BASHKËVEPROJNË

- 118: Kodi i Sjelljes së Nxënësit
- 206: Vendorsja në shkollat e Drejtorisë
- 248: Ngacmimet
- 249: Bullingu/Bullingu me mjete elektronike
- 251: Nxënësit e Pastrehë

DATA EFEKTIVE 8 Shtator 2015